REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:025674

Datë: 30.05.2022

Numri i dokumentit: 03074752

P.nr.873/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me bashkëpunëtoren profesionale Majlinda Shala, në çështjen penale kundër të akuzuarit Gj.Xh., nga fshati Petrovë, Komuna e Prizrenit, me numër personal **.....**, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (nr.06/L-074), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP.II.nr.243-15/2021, të datës 10.08.2021, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit – Shpend Binaj, të akuzuarit Gj.Xh.,, mbrojtësit të tij, av.A.Sh., nga Prizreni dhe të dëmtuarit N.B.,, me dt.10.05.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.05.2022 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

GJ.XH.,, nga i ati **.....**dhe e ëma **.....**, e vajzërisë **.....**, i lindur më **.....** në fshatin **.....**, Komuna e Prizrenit, tani me vendbanim në fshatin Petrovë, Komuna e Prizrenit, Rr.” **.....**”, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i katër fëmijëve, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se në periudhën kohore nga muaji Maj deri në muajin Tetor 2019, në Prizren, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, apo për personin tjetër, e mashtron duke e vënë në lajthim të dëmtuarin N.B., dhe me këtë e nxitë të njëjtin që të kryejë veprime të cilat rezultojnë në dëmtimin material të pasurisë së të njëjtit në shumën prej 500 €, në atë mënyrë që i akuzuari fillimisht e sugjeron të dëmtuarin N**.....** që parat prej 500 € të ia dërgon përmes agjencisë së autobusëve “**.....**”, në emër të shpenzimeve se gjoja se i njëjti do ta pajisë me një vizë pune djalin e tij – H.B., dhe atë në firmë të tij “**.....**” me seli në Slloveni, ashtu që i akuzuari **.....**i merr të hollat e dërguara nga i dëmtuari **.....**nga autobusi “**.....**”, pranimin e të cilave i akuzuari vetë ia konfirmon të dëmtuarit nëpërmjet aplikacionit “Viber”, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material në shumën e lartcekur.

2021:176806

Me këto veprime ka kryer veprën penale, mashtrimi nga neni 323 par.1 i KPRK–së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilën dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast se i akuzuari nuk dëshiron, apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro, llogaritet një ditë burgim.

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin e paraparë, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro, llogaritet një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarit N.B., nga fshati **.....**, Komuna e Prizrenit, t'ia paguajë dëmin në shumë prej 500 (pesëqind) euro dhe atë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro dhe në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën nën numrin PP.II.nr.243-15/2021, të datës 10.08.2021, kundër të akuzuarit Gj.Xh., nga fshati **.....**, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.243-15/21 të datës 09.08.2021.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka dëgjuar Prokurorin e Shtetit, mbrojtësin e të akuzuarit si dhe të akuzuarin.

Prokurori i Shtetit–Shpend Binaj, gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: Prokuroria Themelore në Prizren ka lidhur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë konform dispozitave të nenit 233 të KPRK-së, me të pandehurin Gj.Xh.,, ku prezent ka qenë edhe mbrojtësit i tij av.A.Sh., nga Prizreni, në të cilën marrëveshje i janë shpjeguar në mënyrë detale kushtet e marrëveshjes ku i pandehuri e ka pranuar marrëveshjen e cila është nënshkruar edhe nga kryeprokurori, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj këtë

2021:176806

marrëveshje dhe të pandehurit t'ia shqiptoj dënimin e rekomanduar si në pikën katër të marrëveshjes duke konsideruar se dënimi është konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj.Xh.,, av.A.Sh., gjatë seancës ka deklaruar se: pas negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe pas gjithë atyre konsultave me të mbrojturin tim pa ndikim dhe presion nga askush dhe sipas bindjes së tij të lire, me vetëdije të plotë duke shikuar edhe lehtësimet ligjore me pranimin e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare pa ndonjë shtrëngim nga të tjerët është nënshkruar marrëveshja, njëherit ka shprehur pendim për veprën në fjalë, andaj ka kërkuar nga gjykata të pranojë marrëveshjen e lidhur ndërmjet Prokurorisë Themelore dhe të mbrojturit të tij.

I akuzuari Gj.Xh.,, gjatë seancës ka deklaruar se: pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij, duke shtuar se shpreh keqardhje për rastin.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit të të akuzuarit si dhe vet të akuzuarit, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatojë se i akuzuari Gj.Xh.,, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A.Sh.,, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar, ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuara edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par.1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit Gj.Xh.,, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka dëgjuar deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit qysh në fazat e hershme të procedurës sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, pendesën e shprehur për veprimet e kryera, rrethanat personale të të akuzuarit, qëndrimin korrekt para gjykatës si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprime kundërligjore. Kështu, duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale, të cilat i posedon i akuzuari dhe sipas bindjes së gjykatës dënimi i tillë do të ndikojë mjaftueshëm tek i akuzuari dhe në rrethinën ku ai jeton që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla inkriminuese.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë konformë nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Vendimi për programin e kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 te ligjit me nr.05/L-036.

2021:176806

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI PENAL
2021:025674
P.nr.873/21, të dt.10.05.2022

Bashkëpunëtorja profesionale
Majlinda Shala

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

2021:176806